

# FUQIZIMI I PËRGGJIGJEVE INSTITUCIONALE NDAJ INCIDENTEVE TË SIGURISË NË KOMUNITETET JO SHUMICË (SERB)

**Autori i raportit:**

Lulzim Peci

**Botues:**

NGO AKTIV

**Redaktorët:**

Miodrag Milićević and Igor Marković

**Qershor 2023**

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare nga UNMIK-u në kuadër të projektit "Fuqizimi i përgjigjeve institucionale ndaj incidenteve të sigurisë në komunitetet joshumicë".

Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e OJQ AKTIV dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNMIK-ut.

# PËRMBAJTJA

---

Hyrje	5
Një analizë e shkurtër e kornizës ligjore: procedurat penale	7
Analiza kontekstuale dhe e të dhënave të veprave penale	11
Mekanizmi i Grupit Qytetarësh për Reagim të Shpejtë të OJQ AKTIV	13
Analiza statistikore krahasuese e KIPRED-id	17
Konkluzioni	23
Rekomandimet	25



Shumë incidente që kanë ndodhur në zonat e populluara nga komuniteti serb në Kosovë, siç raportohet nga organizatat<sup>1</sup> dhe mediat e shoqërisë civile serbe, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë (2020/2021), kanë pasur ndikim në marrëdhëniet ndëretnike, besimin në institucione dhe procesin e dialogut mes Prishtinës dhe Beogradit.

Megjithatë, nuk ka raporte në dispozicion për publikun se si institucionet e sundimit të ligjit i trajtojnë ato incidente nga brenda, duke përfshirë mjetet juridike të zbatuara nga organet përkatëse. Ky projekt synon të ofrojë një pasqyrë të përgjigjes institucionale ndaj incidenteve të raportuara për të fuqizuar llogaridhënien publike të këtyre institucioneve në nivel lokal dhe qendror, me një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e besimit në institucionet, marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, dhe rritjen e ndjenjës së siguriës brenda komunitetit serb.

Për këtë qëllim, KIPRED-i, në bashkëpunim me OJQ AKTIV, ka planifikuar të realizojë hulumtime bazuar në të dhënat parësore nga stacionet dhe nënstacionet e Policës së Kosovës, Prokuroria, Gjykatat Themelore dhe Gjykatat e Apelit në të gjitha lokacionet ku kanë ndodhur këto incidente të raportuara për të kontrolluar statusin e tyre brenda institucioneve të sundimit të ligjit. Hulumtimi ka planifikuar të shqyrtojë një mostër prej shtatëdhjetë (70) incidentesh të raportuara gjatë viteve 2020 dhe 2021, sipas kategorive të mëposhtme: djegie/rrënim shtëpish, dëmtim/vjedhje/plaçkitje të familjeve, vjedhje/dëmtime të institucioneve publike, vjedhje /dëmtime të objekteve fetare dhe kulturore dhe sulme fizike.

Për një pasqyrë më të gjerë mbi funksionimin e institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë, hulumtimi ka planifikuar gjithashtu të analizojë përgjigjet ndaj njëzet (20) incidenteve që kanë ndodhur në zonat me shumicë shqiptare të regjistruara nga Policia e Kosovës në vitin 2020 dhe 2021. Dhe kjo supozohet të krahasohet me pesëdhjetë (50) incidente që kanë ndodhur në zonat e banuara me serb të Kosovës.

---

<sup>1</sup> Shih për shembull: Grupi qytetarësh për reagim të shpejtë (RRCG), Incidentet e siguriës në periudhën 1 janar deri më 30 qershor 2021, NGO AKTIV. <https://ngoAKTIV.org/wp-content/uploads/2023/03/InfografikENG.pdf>

Megjithatë, për faktin se Policia e Kosovës nuk iu përgjigj kërkesave të përbashkëta për të dhënat zyrtare në lidhje me këto raste të raportuara, KIPRED dhe OJQ AKTIV nuk ishin në gjendje të realizonin aktivitetet kërkimore siç ishte planifikuar<sup>2</sup>. Hulumtimi, për shkak të këtyre rrethanave, është kryer në bazë të të dhënave në dispozicion për publikun nga intervistat individuale me viktimat e incidenteve të raportuara dhe të dhënat e mbledhura nga OJQ AKTIV gjatë periudhës kur udhëhiqte Grupin e qytetarëve për reagim të shpejtë (RRCG) që ishte përgjegjës për evidentimin e raporteve publike mbi incidentet që kishin të bënin me lëndime trupore (sulme fizike), vjedhje, vjedhje të rënda, plaçkitje dhe dëmtime të pronave që shënjestër kishin pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës.

Në pika të shkurtëra raporti do të analizojë legjislacionin relevant për procedurën e ndjekur nga Policia dhe Prokuroria e Kosovës mbi veprat penale dhe raportet e tyre periodike dhe vjetore. Megjithatë, fokusi kryesor i këtij raporti do të jetë analiza e të dhënave në lidhje me incidentet e raportuara në OJQ AKTIV (përmes RRCG-së) dhe të dhënave publike të mbledhura nga KIPRED. Së fundi, ky raport do të ofrojë rekomandime për politikën për institucionet e Kosovës për sundimin e ligjit, palët e interesuara ndërkombëtare, mediat dhe shoqërinë civile që synojnë përmirësimin e performancës institucionale dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për këto incidente.

---

<sup>2</sup> Komunikimi i KIPRED dhe OJQ AKTIV me Policinë e Kosovës, 19 maj 2023 dhe 23 maj 2023

# Një analizë e shkurtër e kornizës ligjore: procedurat penale

Ky seksion analizon shkurtimisht legjislacionin që rregullon procedurat e ndjekura nga policia dhe prokuroria në përpjekjet e tyre për të hetuar dhe luftuar veprat penale. Një procedurë penale ka katër faza: fazën e hetimit, fazën e kallzimit penal dhe e pranimit të fajësisë, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik.

Kodi i Procedurës Penale<sup>3</sup> përcakton detyrat, kompetencat dhe procedurat që policia duhet t'i përmbahet gjatë hetimit të veprave penale, duke siguruar trajtimin efektiv dhe të ligjshëm të rasteve të tilla. Pas pranimit të informatës për një vepër penale të dyshuar, policia ndërmerr veprime për të përcaktuar nëse ka dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare<sup>4</sup>. Gjatë procesit hetimor, policia ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të zbulojë vendndodhjen e kryesve, të ndalojë kryesin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja<sup>5</sup>. Përveç kësaj, policia duhet të zbulojë dhe të ruajë gjurmët dhe provat tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova, dhe të mbledhë të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurë penale.<sup>6</sup>

Për të qenë në gjendje t'i kryejë këto detyra në mënyrë efektive, policisë i janë dhënë disa kompetenca. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në, mbledhjen e informacionit nga personat, kryerjen e kontrollit të përkohshëm të automjeteve, udhëtarëve dhe valixheve të tyre, kufizimin e lëvizjes në zona të caktuara nëse është e nevojshme<sup>7</sup>. Policia gjithashtu është e autorizuar të vërtetojë identitetin e personave të përfshirë, të organizojë operacione kërkimi, të shqyrtojë dokumentet përkatës, të merr në pyetje dëshmitarët apo të dyshuarit e mundshëm, të ndërmerr hapat e nevojshëm për të parandaluar rrezikun e afërt për publikun dhe të ndërmarrë çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm dhe i paraparë me ligji<sup>8</sup>. Gjatë hetimit, posa policia të pranoj kërkesën për ndjekje penale nga pala e dëmtuar ose posa të njoftohet se një vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare është kryer, tentuar,

---

<sup>3</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (Kodi nr. 08/L-032), 17 gusht 2022.

<sup>4</sup> Ibid, Neni 71.

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> Ibid.

<sup>7</sup> Ibid.

<sup>8</sup> Ibid.

është duke u kryer apo do të kryhet së shpejti, policia është e detyruar që të mbajë një procesverbal të provave për veprimet e tyre, duke dokumentuar faktet, rrethanat dhe menjëherë të njoftojë prokurorin e shtetit dhe t'i dorëzojë raport policor brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve.<sup>9</sup>

Neni 82 i Kodit të Procedurës Penale<sup>10</sup> përcakton rëndësinë e kallëzimit penal të policisë si një komponent themelor dhe thelbësor në kuadër të procedurës penale. Kallëzimi penal i policisë i përpiluar duke u bazuar në të dhënat dhe provat e mbledhura, i dorëzohet prokurorit të shtetit së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet e tjera brenda tridhjetë (30) ditëve pas veprimit të fundit të ndërmarr nga policia nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se një vepër penale është kryer<sup>11</sup>. Më pas i takon prokurorit të vendos nëse do të iniciojë procedurën penale.<sup>12</sup>

Prokurori është i autorizuar të fillojë hetimin në bazë të kallëzimit të policisë apo burimeve tjera, nëse ka dyshim të arsyeshëm se vepra penale e cila ndiqet është kryer, po kryhet ose ka gjasë që të kryhet në një të ardhme të afërt<sup>13</sup>, marrë parasysh se fillimi i një hetimi të tillë kërkon aktvendim të prokurorit.<sup>14</sup>

Nëse prokurori i shtetit pas përfundimit të hetimit, konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale paraqesin dyshim të bazuar mire, atëherë i njëjti ngre aktakuzë. Në anën tjetër, nëse hetimi ka përfunduar dhe nuk ka prova të mjaftueshme, prokurori nxjerr aktvendimin për pushimin e hetimit.<sup>15</sup>

Vlen të theksohet se, Policia e Kosovës publikon raporte vjetore që shërbejnë si burime të vlefshme për dokumentimin e aktiviteteve të saj, duke përfshirë informacione dhe të dhëna për veprat penale dhe përpjekjet për parandalimin e krimit<sup>16</sup>. Këto raporte ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të rasteve të raportuara, arrestimeve dhe statistikave specifike për lloje të ndryshme të veprave penale si vjedhje, vjedhje e rëndë dhe plaçkitje. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ka kufizime në disponueshmërinë e informacionit për kategori të caktuara të veprave penale, si dhe mungesë të një ndarjeje bazuar në kapitujt e kodit penal. Për më tepër, vërehet një mungesë e dukshme e informacionit lidhur me incidentet dhe ngjarjet në nivel lokal, si në komuna apo rajone, gjë e cila që do të rriste transparencën.

---

<sup>9</sup> Ibid.

<sup>10</sup> Ibid, Neni 82.

<sup>11</sup> Ibid.

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> Ibid, Neni 100.

<sup>14</sup> Ibid, Neni 102.

<sup>15</sup> Ibid, Neni 234.

<sup>16</sup> Policia e Kosovës, Dokumentet strategjike, <https://www.kosovopolic.com/dokumente/dokumentet-strategjike/>



Për më tepër, një çështje e rëndësishme vazhdon në lidhje me informacionin e pamjaftueshëm të ofruar mbi përkatësinë etnike të kryesve dhe viktimave në rastet penale, si në raporte ashtu edhe në burimet në dispozicion për publikun. Kjo mungesë e të dhënave gjithëpërfshirëse pengon të kuptuarit gjithëpërfshirës të dinamikës dhe ndikimit të veprave penale në komunitete të ndryshme. Krahas kësaj, ekziston problemi i përkthimit me kohë të përmbajtjes që publikohet në ueb faqen e Policisë së Kosovës<sup>17</sup> (dhe raportet e saj ditore), përmbajtje që nuk është plotësisht dhe në kohën e duhur e përkthyer në gjuhën serbe (si një nga dy gjuhët zyrtare), e që sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve paraqet obligim ligjor <sup>18</sup>.

Ndërsa, kur bëhet fjalë për Këshillin Prokurorial të Kosovës, të dhënat mbi veprat penale duket të jenë jo të plota. Burimet në dispozicion për publikun, siç janë raportet e punës së Prokurorit të Shtetit, ofrojnë një pasqyrë të rasteve të raportuara penale, numrin e rasteve të zgjidhura dhe të pazgjidhura, raportuesit e veprave penale si dhe informacion të kufizuar për aktvendimet e gjykatës<sup>19</sup>. Megjithatë, ekziston një mangësi e theksuar e cila reflektohet në mungesën e të dhënave gjithëpërfshirëse statistikore që mbulojnë të gjitha kategoritë e veprave penale dhe përfshijnë informacione për përkatësinë etnike të kryesve dhe viktimave në raste të tilla penale.

Adresimi i këtyre boshllëqeve dhe mangësive në sistemet e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, si dhe sigurimi i përfshirjes së ndarjeve nga aspekti etnik, do të kontribuonte shumë në transparencën, llogaridhënien dhe kuptimin e modeleve të krimit brenda Kosovës.

---

<sup>17</sup> OJQ AKTIV, Vlerësimi i statusit të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, f.10, <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/03/Final-ALB-Annual-Report.pdf>

<sup>18</sup> Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>

<sup>19</sup> Raporti Nëntëmujor i Punës së Prokurorit të Shtetit, <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Raporti%20i%20punes%20se%20Prokurorit%20te%20Shtetit%20janar-shtator%202022.pdf>



# Analiza kontekstuale dhe e të dhënave të veprave penale

Pandemia COVID-19, si rezultat i rreziqeve të mëdha që ky virus paraqiste për shëndetin publik për nivelet globale, rajonale, kombëtare dhe lokale të qeverisjes katalizoi një sërë sfidash. Pandemia ka ndikuar përfundimisht në funksionimin e përditshëm të sistemeve socio-politike dhe ekonomike në një mënyrë që nuk ishte përjetuar më parë. Në rrethana të tilla, një çështje që kishte lindur shpesh gjatë rrethanave të jashtëzakonshme të shkaktuara nga kriza pandemike ishte se si të menaxhohej nevoja për masa të jashtëzakonshme për të mbrojtur qytetarët nga përhapja e sëmundjes vdekjeprurëse, duke ruajtur në të njëjtën kohë të drejtat themelore të njeriut dhe normat ligjore e kushtetuese. Kjo e fundit, për shkak të marrëdhënieve të brishta ndëretnike të pasluftës, paqëndrueshmërisë politike dhe keqfunksionimeve institucionale në veri të Kosovës, të cilat janë ndikuar edhe nga procesi i normalizimit të raporteve ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit që ka vazhduar që nga viti 2011 ka paraqitur një sfidë të madhe për Qeverinë e Kosovës.





# Mekanizmi i Grupit Qytetarësh për Reagim të Shpejtë të OJQ AKTIV

<sup>20</sup>Grupi qytetarësh për reagim të shpejtë (RRCG) u formua në maj të vitit 2020 si përgjigje ndaj krizës pandemike me qëllim monitorimin e zbatimit të masave të lëshuara nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal në luftën kundër pandemisë, monitorimin e procesit të vaksinimit, situatës së sigurisë, përfshirë përgjigjen institucionale ndaj nevojave të ndryshme të qytetarëve në zonat e banuara nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë. RRCG përbëhej nga selia (me bazë në Mitrovicën e Veriut) dhe 21 (në vitin 2020) dhe 15 (në vitin 2021) koordinatorë në terren të cilët raportonin për incidentet nga 21 komuna në të gjitha shtatë (7) rajonet e Kosovës

<sup>21</sup> Më shumë informacion rreth angazhimit të RRCG-së: <https://peacefulchange.org/wp-content/uploads/2020/12/25-November-Case-Study-RRCG.pdf>

<sup>22</sup> Shih për shembull raportin e parë të RRCG-së: <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/03/InfoEngPDF.pdf>

<sup>23</sup> Për shembull: <https://ngoAKTIV.org/wp-content/uploads/2023/03/InfografikENG.pdf>

<sup>24</sup> RTV KIM, Empirika: Institucije da preduzmu mere zaštite imovine Srba, <https://www.radiokim.net/vesti/saopstenja/empirika-institucije-da-preduzmu-mere-zastite-imovine-srba.html>

<sup>25</sup> Ambasada Britanike në Prishtinë: <https://shorturl.at/DHNS1>

<sup>26</sup> Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë: <https://shorturl.at/fvwHQ>

Në këto rrethana, si përgjigje ndaj rritjes së perceptuar të numrit të rasteve ku siguria fizike dhe pronësore e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës (dhe të komuniteteve tjera joshumicë) ishte rrezikuar, OJQ AKTIV themeloi Grupin qytetar për reagim të shpejtë (RRCG)<sup>20 21</sup>. Mekanizmi i tillë monitorues kishte për qëllim vëzhgimin nga afër të procedimit të rasteve që për shënjestër kishin pjesëtarët e komuniteteve joshumicë dhe zhvillimet përkatëse. Njëkohësisht, gjatë monitorimit të të masave të ndërmarra nga institucionet qendrore dhe lokale për të luftuar pandeminë dhe pasojat e saj në zonat në mbarë Kosovën të populluara nga komunitetet jo-shumicë, RRCG hetoi, hartoi, klasifikoi dhe më vonë publikoi raporte mbi incidentet në ato zona.

Metodologjia e përdorur për hartëzimin e incidenteve ishte projektuar dhe strukturuar metodologjikisht në mënyrë të tillë që të përfshinte burime të ndryshme informacioni që do të plotësonin njëra-tjetrën dhe në fund do të ishin faktike dhe të verifikuara në mënyrë adekuate. Për të arritur këtë qëllim u mblodhën të dhëna përmes raporteve të standardizuara, ditore, në kohë reale të koordinatorëve të RRCG (të vendosura në pjesë të ndryshme të Kosovës), raporteve të policisë, intervistave me viktimat e incidenteve dhe përfaqësuesve përkatës të institucioneve, duke përfshirë procesin e monitorimit të medias.

RRCG monitoroi incidentet në zonat e populluara nga pjesëtarët të komunitetit serb<sup>22</sup> që jetojnë në jug të lumit Ibër, si dhe në vendbanimet periferike multi-etnike përgjatë bregut verior të të njëjtit lumë. Të dhënat u ndanë me audiencën më të gjerë në Kosovë dhe u publikuan në baza vjetore dhe dyvjeçare<sup>23</sup>.

Gjatë periudhës së pandemisë lidhur me incidentet që për shënjestër kishin pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës, përveç përfaqësuesve të OJQ-ve dhe mediave serbe<sup>24</sup> të Kosovës, shqetësime kanë ngritur edhe pjesëtarët e komunitetit ndërkombëtar<sup>25 26</sup>.

Në Raportin e Departamentit të Shtetit për të drejtat e njeriut në Kosovë për vitin 2020 thuhej se përfaqësuesit e komunitetit serb kanë shprehur shqetësime për vjedhjet, thyerjet, ngacmimet verbale dhe dëmtimet pronave që për shënjestër kishin serbët e Kosovës, veçanërisht ata që ktheheshin në zonat rurale. Raporti thekson se OJQ AKTIV, në periudhën mars-qershor 2020 ka dokumentuar mbi 20 incidente, duke përfshirë zjarrvënie, sulme fizike dhe plaçkitje të drejtuara ndaj serbëve të Kosovës. Për më tepër, nga janari deri në tetor, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka pranuar ankesa për 49 incidente lidhur me sigurinë që prekin serbët e Kosovës dhe të kthyerit<sup>27</sup>. Si kundërpërgjigje, kjo Ministri i kërkoi publikisht policisë që të shtojë patrullimet në zonat kryciale dhe të sigurojë që kryesit të arrestohen dhe mbahen përgjegjës.








<sup>27</sup> Ibid.

<sup>28</sup> State Department, Country Reports on Human Rights Practices for 2020, Kosovo 2020 Human Rights Report, <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/03/KOSOVO-2020-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

<sup>29</sup> State Department, Country Reports on Human Rights Practices for 2021, Kosovo 2021 Human Rights Report, [https://www.state.gov/wp-content/uploads/2022/02/313615\\_KOSOVO-2021-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf](https://www.state.gov/wp-content/uploads/2022/02/313615_KOSOVO-2021-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf)

Vlen të theksohet se në raport evidentohet edhe fakti se në raste të caktuara, arrestimet e kryesve kanë ardhur si rezultat i hetimeve të policisë<sup>28</sup>. Gjithashtu, Raporti i Departamentit të Shtetit për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2021 përshkruan situatën në lidhje me këto lloj incidentesh me një ton të ngjashëm<sup>29</sup>.

Sipas të dhënave të mbledhura nga anëtarët e RRCG-së në koordinim me OJQ AKTIV, gjatë viteve 2020 dhe 2021, ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të rasteve ku siguria private dhe pronësore në zonat e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës është rrezikuar. Që nga fillimi i vitit 2020 deri në fund të vitit 2021, është konstatuar se në këto zona në Kosovë kanë ndodhur gjithsej **163 incidente (76 në vitin 2020 dhe 87 në vitin 2021)**, të ndara në kategoritë si në vijim:

39	raste të dëmtimit/vjedhjeve/plaçkitjeve të shtëpive në pronësi të serbëve	
38	raste të sulmeve fizike ndaj pjesëtarëve të komunitetit serb	
30	raste të dëmtimit të pronës dhe objekteve fetare të Kishës Ortodokse Serbe	
21	raste të grafiteve në objekte publike ose private, përmbajtja e të cilave është fyese, përmban elemente të gjuhës së urrejtjes, kërcënon ndjenjat fetare ose identitare dhe u drejtohet pjesëtarëve të komunitetit serb	
17	raste të vjedhjeve të pasurive të luajtshme private	
11	raste sulmesh ndaj pronave të institucioneve publike (që ofrojnë shërbime publike, si institucione shëndetësore, arsimore dhe administrative) dhe	
7	raste të djegies apo rrënimit të shtëpive (dhe/ose objekteve ndihmëse) në pronësi të personave të nacionalitetit serb	

Incidentet e lartpërmendura kanë ndodhur në **27 komuna**<sup>30</sup>, dhe në tabelën në vijim mund të vërehet progresi i tyre në shtatë rajone të Kosovës:

	2020				2021				GJITHSEJ
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	
<b>PRISHTINË</b>	4	9	7	10	6	10	7	7	<b>60</b>
<b>MITROVICË</b>	3	5	1	1	2	4	3	3	<b>22</b>
<b>PEJË</b>	2	13	4	3	6	2	1	2	<b>33</b>
<b>PRIZREN</b>	2	1	1	●	1	●	●	●	<b>5</b>
<b>GJAKOVË</b>	●	2	●	1	1	5	4	4	<b>17</b>
<b>GJILAN</b>	3	1	1	2	5	4	4	2	<b>22</b>
<b>FERIZAJ</b>	●	●	●	●	2	1	1	●	<b>4</b>
<b>GJITHSEJ</b>	<b>14</b>	<b>31</b>	<b>14</b>	<b>17</b>	<b>23</b>	<b>26</b>	<b>20</b>	<b>18</b>	<b>163</b>

<sup>30</sup> Graçanicë (32), Istog/k (16), Rahovec (14), Obiliq (13), Vushtrri (9), Klinë (9), Peja (8), Mitrovica e Veriut (7), Viti (6), Klllokot (5), Prizren (5), Gjilan (5), Novobërdë (5), Lipjan (4), Prishtinë (4), Kamenicë (3), Gjakova (3), Shtërpçë (3), Zubin Potok (2), Mitrovica e Jugut (2), Parteshi (2), Zveçan (1), Ferizaj (1), Ranillug (1), Fushë Kosovë (1), Podujevë/o (1), Skenderaj (1)





# Analiza statistikore krahasuese e KIPRED-id

Për dallim nga të gjeturat dhe të dhënat e lartpërmendura, Policia e Kosovës për vitin 2020, që ishte periudhë e pandemisë së rëndë raportoi se janë regjistruar **27.404** vepra penale, prej tyre **250** raste të lëndimeve të rënda trupore (sulme fizike), vjedhje **3.863**, vjedhje të rënda **3.455** raste, dhe plaçkitje **148** raste<sup>31</sup>. Në vitin 2021, ky numër i veprave penale është rritur lehtë në **30.108** raste të veprave penale, prej tyre **296** raste të lëndimeve të rënda trupore, vjedhje **4.333**, vjedhje të rënda **3223** raste dhe plaçkitje **158** raste<sup>32</sup>.

Për më tepër, analizat e KIPRED-it për këto vepra penale të publikuara kanë zbuluar se në raportet ditore të Policisë së Kosovës<sup>33</sup> në mënyrë disproporcionale ka pasur më pak raste të raportuara në krahasim me Raportin Vjetor të Policisë së Kosovës 2021, i cili ka mbuluar edhe vitin 2020.

Bazuar në të dhënat e marra nga raportet ditore të Policisë së Kosovës dhe raportet e mediave që i referohen informacioneve të siguruar nga Policia e Kosovës<sup>34</sup>, në periudhën janar 2020 deri në dhjetor 2021, në nivel kombëtar janë regjistruar 251 raste të këtyre veprave penale. Këto raste janë kategorizuar në dhjetë vepra, duke përfshirë vjedhje (102 raste), plaçkitje (36 raste), vjedhje e rëndë (40 raste), vjedhje e objekteve fetare (5 raste), sulme fizike (51 raste), dëmtime të pronës (3 raste), shkatërrim/djegje shtëpish (1 rast), vjedhje me armë (2 raste), plaçkitje me armë (8 raste) dhe zjarrvënie (3 raste).


<sup>31</sup> Policia e Kosovës, Raporti vjetor i punës, Janar – Dhjetor 2021, f.7 dhe f.10, [https://www.kosovopolicice.com/wp-content/uploads/2022/03/RAPORTI-VJETOR-I-PUNËS-I-POLICISË-SË-KOSOVËS\\_shqip.pdf](https://www.kosovopolicice.com/wp-content/uploads/2022/03/RAPORTI-VJETOR-I-PUNËS-I-POLICISË-SË-KOSOVËS_shqip.pdf)

<sup>32</sup> Ibid.

<sup>33</sup> Raportet ditore të Policisë së Kosovës, <https://www.kosovopolicice.com/en/informations/>

<sup>34</sup> Kallxo.com, Postet nga Raporti Ditor i Policisë, <https://kallxo.com/tag/raporti-ditor-i-policise/>

## VEPRAT PENALE TË RAPORTUARA NË RAPORTET DITORE TË POLICISË SË KOSOVËS 2020-2021




Zbërthimi i këtyre rasteve nëpër komuna të ndryshme në Kosovë është si në vijim: Prishtinë (31 raste), Mitrovicë e Jugut (19 raste), Mitrovicë e Veriut (19 raste), Deçan (5 raste), Ferizaj (17 raste), Suharekë (6 raste), Prizren (21 raste), Rahovec (2 raste), Pejë (23 raste), Obiliq (6 raste), Zubin Potok (12 raste), Fushë Kosovë (12 raste), Gjakovë (6 raste), Gjilan (6 raste), Graçanicë (14 raste), Istog (2 raste), Janjevë (1 rast), Kamenicë (1 rast), Klinë (2 raste), Klllokot (4 raste), Leposaviq (1 rast), Lipjan (1 rast), Malishevë (2 raste), Podujevë (5 raste), Shtërpcë (3 raste), Ranillug (1 rast), Partesh (6 raste), Shtime (3 raste), Viti (3 raste), Vushtrri (10 raste), Zveçan (4 raste), dhe të panjohura (3 raste).

Tabela në vijim paraqet këto të dhëna të ndara sipas zonave të mbuluara nga Drejtoritë përkatëse të Policisë së Kosovës.

<b>RAJONI</b>	<b>PERIUDHA 2020 – 2021</b>
PRISHTINË	71
MITROVICË E JUGUT	38
MITROVICË E VERIUT	28
PEJË	31
PRIZREN	30
GJAKOVË	6
GJILAN	20
FERIZAJ	24
UNKNOWN	3
<b>TOTAL</b>	<b>251</b>


Analiza tregon se Prishtina, si kryeqytet, ka numrin më të madh të rasteve penale të raportuara, gjë që sugjeron një shkallë relativisht më të lartë të krimit në atë rajon. Ky vrojtim përputhet me të kuptuarit e përbashkët se qendrat urbane për shkak të faktorëve të tillë siç është dendësia e popullsisë shpesh përjetojnë shkallë më të lartë të krimit. Përveç kësaj, një numër i konsiderueshëm i rasteve të raportuara të veprave penale janë gjetur në Prizren, Pejë dhe Mitrovicë të Veriut, që tregon praninë e konsiderueshme të shkallës së krimit në këto zona.



Bazuar në të dhënat e mbledhura nga KIPRED, kishte dallime të dukshme në numrin e rasteve të raportuara të veprave penale në periudhën 2020 dhe 2021. Në vitin 2020, në këto raporte janë evidentuar 95 raste të veprave penale të këtyre llojeve; në vitin 2021, numri i rasteve të regjistruara u rrit në 156.


Viti 2020, i cili përkoi me pandeminë COVID-19 dhe zbatimin e masave parandaluese, pati një numër relativisht më të ulët të rasteve të veprave penale të raportuara. Kjo mund t'i atribuohet mbylljeve, kufizimeve në udhëtim dhe masave të distancimit social, që me gjasë kanë kufizuar mundësitë për aktivitete kriminale. Për më tepër, prania e shtuar e zbatimit të ligjit dhe zbatimi më i rreptë i rregulloreve të lidhura me pandeminë mund të kenë penguar shkelësit e mundshëm. Megjithatë, në vitin 2021, pati një rritje të konsiderueshme të rasteve të raportuara të veprave penale. Me heqjen graduale të kufizimeve dhe rifillimin e aktiviteteve ekonomike, u duk se aktivitetet kriminale po rikuperoheshin, duke përfituar nga rritja e ndërveprimeve dhe lëvizjeve sociale.

Këto raste për vitin 2020 dhe 2021 arrijnë në **251** vepra penale të raportuara nga raportet ditore të Policisë së Kosovës. Kjo paraqet **1.57%** të rasteve krahasuar me të dhënat e Raportit Vjetor të Punës së Policisë së Kosovës për vitin 2021, i cili për të njëjtën periudhë ka regjistruar **15.986** raste të këtyre llojeve të veprave penale. Kjo nxjerr në pah një mospërputhje të konsiderueshme midis dy grupeve të të dhënave.



Në anën tjetër, këto shifra sugjerojnë se përqindja e veprave penale (përfshirë lëndimet trupore, vjedhjet, vjedhjet e rënda dhe plaçkitjet) që kanë për shënjestër pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës, siç raportohet nga RRCG, ishte **0.98%** në vitin 2020 (**76** raste) dhe **1.09%** në vitin 2021 (**87** raste), krahasuar me numrin e përgjithshëm të rasteve në Kosovë siç është paraqitur në Raportin Vjetor të Punës së Policisë së Kosovës (**7,716** raste në vitin 2020 dhe **7,970** raste në vitin 2021).

Përkundër këtyre përqindjeve të ulëta të rasteve të veprave penale, në krahasim me statistikat e përgjithshme të ofruara nga Policia e Kosovës, për këto çështje nuk janë regjistruar përgjigje sistematike nga institucionet e sundimit të ligjit, përkatësisht nga Policia e Kosovës dhe gjyqësori, gjë që më tej kontribuon në perceptimet e besimit të pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës<sup>35 36</sup>.



<sup>35</sup> Në lidhje me këtë, sipas tetë (8) intervistave të realizuara nga OJQ AKTIV gjatë muajit prill dhe maj 2023 me pjesëtarët e komunitetit të kthyer të nacionalitetit serb në Pejë, Istog, Klinë (të cilët ishin viktimë të incidenteve të raportuara përmes RRCG-së) ekziston “një mungesë totale e besimit në Policinë e Kosovës dhe Prokurorinë në atë masë sa që ndihen të pasigurt për të raportuar incidentet për shkak të frikës se procesi i hetimit mund t’i rrezikojë edhe më shumë ata”

<sup>36</sup> Sipas publikimit vjetor të anketimit të opinionit nga OJQ AKTIV, Analiza e trendit (nga viti 2021), 74% e pjesëtarëve të anketuar të komunitetit serb të Kosovës besojnë se gjendja e sigurisë në Kosovë është e keqe: <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/01/Analiza-21-Final-English-1.pdf>

Megjithatë, vlen të theksohet se sipas Barometrit të Sigurisë të publikuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në nëntor të vitit 2020, besimi i komunitetit serb në Policinë e Kosovës ishte i moderuar. Ku në Policinë e Kosovës 4% e të anketuarve serbë kanë besim të plotë, 18% kanë besim dhe 19% kanë deri diku besim<sup>37</sup>. Në anën tjetër, besimi në mesin e të anketuarve serbë në gjykatat e Kosovës ishte shumë më i ulët. Vetëm 2% kanë besim të plotë, 6% kanë besim dhe 38% prej tyre thanë sa kanë deri diku besim<sup>38</sup>.

Mospërputhjet e vërejtura nxjerrin në pah nevojën e ndryshimit të metodologjisë së ofrimit të të dhënave për veprat penale nga Policia e Kosovës pasi që të dhënat e ofruara në raportet ditore duhet të përkojnë me ato të dhëna të raporteve vjetore. Për më tepër, ekziston nevoja për të ofruar një ndarje të këtyre të dhënave sipas komunave në mënyrë që ato të bëhen më të qasshme për komunitetet lokale dhe të mundësohet një kuptim më i mirë i ndikimit ndaj etniteteve dhe gjinive të ndryshme. Kjo do të ndihmonte në krijimin e kushteve për rritjen e besimit midis grupeve të cënueshme. Gjithashtu, është e rëndësishme të sigurohen statistika për statusin e hetimeve për të gjitha kategoritë demografike të sipërpërmendura në këto raste.

---

<sup>37</sup> QKSS, Barometri i Sigurisë për Ballkanin Perëndimor, f.8. Nëntor 2020. [https://qkss.org/images/uploads/files/WBSB\\_KosovoReport\\_Alb\\_final\\_988743.pdf](https://qkss.org/images/uploads/files/WBSB_KosovoReport_Alb_final_988743.pdf)

<sup>38</sup> Ibid. f.11



Ky hulumtim është fokusuar në analizimin e veprave penale, përfshirë lëndimet trupore, vjedhjet, vjedhjet e rënda, plaçkitjet dhe dëmtimet e pronës, që kanë ndodhur gjatë periudhës së pandemisë 2020-2021, me theks të veçantë në rastet kur të prekur ishin pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë. Qëllimi ishte të vihej në pah përgjigja institucionale ndaj këtyre incidenteve dhe të rritet llogaridhënia publike në nivel lokal dhe qendror, duke nxitur përfundimisht besimin në institucione, duke përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike dhe duke rritur ndjenjën e sigurisë brenda komunitetit serb.

Fatkeqësisht, hulumtimi u përball me kufizime të ashpra për shkak të dështimit të Policisë së Kosovës për të ofruar informacionin e kërkuar, duke i detyruar kështu studiuesit të mbështeten vetëm në të dhënat në dispozicion për publikun dhe të dhënat e mbledhura nga Grupi qytetarësh për reagim të shpejtë (RRCG) të udhëhequr nga AKTIV. Megjithatë, analiza e këtyre të dhënave, siç është dokumentuar nga RRCG, ka nxjerrë në pah një numër të konsiderueshëm të rasteve të raportuara gjatë periudhës së specifikuar, me 76 raste në vitin 2020 dhe 87 raste në vitin 2021. Këto shifra tërëhoqën vëmendjen ndërkombëtare, duke përfshirë shqetësimin e Departamentit të Shtetit të SHBA-së, siç theksohet në Raportet e të Drejtave të Njeriut në Kosovë për vitin 2020 dhe 2021.

Nga ana tjetër, sipas Policisë së Kosovës (Raporti Vjetor i Punës 2021) në nivel të Kosovës në vitin 2020 janë raportuar 7716 të tilla dhe 7970 në vitin 2021. Këto shifra sugjerojnë se përqindja e veprave penale (përfshirë lëndimet trupore, vjedhjet, vjedhjet e rënda dhe plaçkitjet) që kishin për shënjestër pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës, siç raportohet nga RRCG, ishte 0.98% në vitin 2020 (76 raste) dhe 1.09% në vitin 2021 (87 raste), krahasuar me numrin e përgjithshëm të rasteve në Kosovë siç është paraqitur në Raportin Vjetor të Punës së Policisë së Kosovës (7,716 raste në vitin 2020 dhe 7,970 raste në vitin 2021).

Megjithatë, përkundër këtyre shifrave të konsiderueshme, lidhur me këto çështje ka munguar reagimi sistematik nga institucionet e sundimit të ligjit, veçanërisht Policia e Kosovës dhe gjyqësori. Kjo edhe më tej kontribuon në erozionin e besimit në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës. Për më tepër, statistikat e përgjithshme të ofruara nga Policia e Kosovës nuk ofrojnë asnjë ndarje të të dhënave në bazë të përkatësisë etnike dhe gjinore, duke kufizuar mundësinë për të kuptuar plotësisht dinamikën e këtyre veprave penale.

Për më tepër, janë vërejtur mospërputhje ndërmjet të dhënave në dispozicion për publikun nga raportet ditore të Policisë së Kosovës dhe Raportet Vjetore të Punës së Policisë së Kosovës. Përderisa KIPRED-i përmes raporteve ditore ka identifikuar 251 raste të veprave penale për vitin 2020 dhe 2021, Raporti Vjetor i Punës së Policisë së Kosovës tregon një numër dukshëm më të lartë të rasteve, gjithsej 15,986 rastesh për të njëjtën periudhë.



- **Përmirësimi i transparencës, bashkëpunimit dhe saktësisë së të dhënave** ndërmjet institucioneve të sundimit të ligjit dhe drejtësisë në Kosovë. Kjo do të lehtësojë transparencën, llogaridhënien dhe përcjelljen gjithëpërfshirëse të rasteve të veprave penale, duke forcuar përfundimisht sistemin e përgjithshëm të drejtësisë penale në Kosovë;
- **Policia e Kosovës dhe Gjyqësori** duhet të kenë prioritet zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve të fuqishme të të dhënave dhe raportimit që përfshijnë raportimin e rasteve penale në polici, statusin e hetimeve dhe statusin e aktakuzave. Përveç kësaj, këto sisteme duhet të përfshijnë ndarje gjithëpërfshirëse bazuar në demografinë komunale, etnike dhe gjinore. Kjo qasje jo vetëm që do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien, por gjithashtu do të sigurojë një kuptim më të thellë të dinamikës dhe pabarazive brenda sistemit të drejtësisë penale, duke mundësuar ndërhyrje më të synuara dhe efektive për adresimin e nevojave specifike të komuniteteve të ndryshme në Kosovë;
- Është e domosdoshme që të bëhen përpjekje të përbashkëta për të **adresuar shqetësimet e ngritura nga bashkësia ndërkombëtare** lidhur me veprat penale të raportuara që posaçërisht kanë për shënjestër pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, veçanërisht komunitetin serb, si dhe grupet e tjera të marginalizuara;
- **Policia e Kosovës, Gjyqësori dhe Prokuroria** duhet të punojnë ngushtë për të bashkëpunuar me qëllim të sinkronizimit sistematik të aktiviteteve që do të çojnë në rritjen e zgjidhjes së rasteve të incidenteve në kohë dhe në mënyrë adekuate ligjore;

- **Policia e Kosovës** duhet të punojë më ngushtë me pjesëtarët e komuniteteve të varfra dhe të cenueshme të të kthyerve në zonat/vendbanimet ku incidentet e sigurisë ishin më të shpeshta dhe rrallë të trajtuara;
- **Policia e Kosovës** duhet të sigurojë që të gjitha dokumentet dhe raportet publike të përkthehen në mënyrë adekuate dhe në kohën e duhur në gjuhën serbe;
- **Vendimmarrësit e nivelit lokal dhe qendror** duhet të jenë më të zëshëm në dënimin e akteve të dhunës në zonat multietnike, duke kontribuar kështu në një ndjenjë pozitive të sigurisë dhe mbrojtje adekuate nga institucionet përkatëse
- Me qëllim të informimit të audiencës më të gjerë, mediave dhe palëve relevante të interesuara në Kosovë mbi progresin në aspektin e përgjigjeve institucionale ndaj rasteve të shkeljes së ligjit, Policia e Kosovës duhet të publikojë **raporte statistikore tremujore dhe dyvjeçare**, në të cilat do të bëhet ndarja e të dhëna në nivel komunal, rajonal dhe kombëtar

Zbatimi i këtyre masave do të mundësojë krijimin e një kornize më të fuqishme që nxit besimin, gjithëpërfshirjen dhe zbatimin efektiv të sundimit të ligjit në Kosovë.



MBËSHTETUR NGA UMNÏK-U